



RAPORT

MBI PRIORITETET E QYTETARËVE TË MBLEDHURA PËRMES VOTIMIT ONLINE

NË BASHKINË FIER

2019



Publikim i të dhënave të kërkesave të qytetarëve në projektin: “Përmirësimi i Procesit të Buxhetimit të Konsultuar dhe me Pjesëmarrje” në Bashkinë Fier

Të nderuar përfaqësues të pushtetit vendor,

Qendra Rinore Epoka e Re në partneritet me **Institutin AGENDA** dhe mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, ka zbatuar një projekt që ka si qëllim kryesor rritjen e ndikimit direkt të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive me anë të një instrumenti efikas. Për rritjen e aksesit të qytetarëve në hartimin e buxhetit të bashkive është krijuar platforma **www.buxhetim.al** ku çdo qytetar mund të shprehë preferencat e tij për buxhetin e bashkisë. Në bashkinë Fier platforma u shfrytëzua nga qytetarët gjatë periudhës 30 tetor - 20 dhjetor 2019. Të dhënat e mbledhura nga aplikacioni janë përpunuar dhe analizuar nga stafi dhe ekspertët e Institutit, duke nxjerrë edhe rezultatet mbi preferencat e qytetarëve që janë paraqitur më poshtë në këtë raport. Duke i shpërndarë këto të dhëna pranë drejtuesve të Bashkisë dhe Këshillit bashkiak, synohet informimi i autoriteteve mbi mendimet e shprehura nga qytetarët dhe mundësia që të merren parasysh në hartimin e buxhetit përfundimtar.

Të dhënat e mbledhura në Bashkinë Fier

Nga bashkia Fier 281 qytetarë janë përfshirë në plotësimin e formularit duke shprehur prioritetet e tyre mbi zërat e buxhetit, nga të cilët 172 janë *meshkuj* dhe 109 janë *femra*.




Figura 1.1 Gjinia e qytetarëve




Figura 1.2 Mosha e qytetarëve




Figura 1.3 Arsimimi i qytetarëve

- **Kategoritë e buxhetit**




Figura 1.4 Kategoritë e buxhetit

- **Nënkategoritë e buxhetit**

Zërat e buxhetit	Numri	Përqindja
Investime dhe mirëmbajtje terrenesh sportive	74	11%
Investime në rrugë urbane, rurale, sheshe	57	8%
Organizimi i aktiviteteve rinore dhe sportive	53	8%
Sipërfaqe të gjelbërta	44	7%
Ujitja dhe kullimi	42	6%
Ndihma ekonomike	31	5%
Ujësullës kanalizime	26	4%
Mirëmbajtja e rrugëve rurale	26	4%
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave	25	4%
Përmirësimi i sinjalistikës rrugore	21	3%
Banesa sociale	21	3%

Tabela 1.1 Nënkategoritë e buxhetit

- **Prioritetet sipas gjinisë**



Figura 1.5

- **Prioritetet sipas moshës**




Figura 1.6

- **Prioritetet sipas arsimimit**




Figura 1.7

• Sugjerimet e qytetarëve të Fierit

1. Më shumë hapësira të gjelbërta dhe të ngrihen qendra për njerëz të vetmuar sidomos njerëz të moshës së tretë.
2. Dizenjim i sinjalistikës rrugore horizontale. Qendra kulturore e fëmijëve. Të investohet për kurset dhe grupet e QKF. Ndriçim i rrugëve brenda lagjeve.
3. Mrojtja e pyjeve të zonave përreth Fierit të cilat dëgjohej që dita ditës shfrytëzohen duke u prer për tu përdorur për tu ngrohur dhe dëgjohej që digjen dita ditës.
4. Aktivitete rinore për moshë të caktuar pasi me kalimin e kohës janë venitur si shoqëria dhe aktiviteti rinor.
5. Lagja Kryengritja e Fierit nuk ka ndriçim. Nuk ka park për argëtim për fëmijët.
6. Të përmirësohet rrjeti ujësjellës. Kullimet e rrugëve në periferi si dhe pusetat e rrugëve.

7. Mendoj se qyteti jonë ka nevojë imediate për ndërtimin e një pallati sporti për lojrat me dorë. Është urgjente mendoj unë pasi ndeshjet zhvillohen jashtë qytetit në mungesë të një pallati sporti.
8. Ulja e numrit të fëmijëve për një edukator, që edukatorja të mund të ndikojë në formimin e fëmijës.
9. Mendoj se Kryetari i Bashkisë është duke bërë një punë shumë të mirë por ka akoma shumë punë për të bërë, duhet patjetër të rregullohen gjërat dhe që ne ta bëjmë bashkinë tonë më të bukurën nga të gjitha dhe me kushte të mira ka akoma gjëra që duhen rregulluar, e para infrastruktura rrugore, e dyta fusha sportive dhe pallati i sportit që na mungon. Faleminderit!
10. Rruga Vangjel Çapo dhe ura me pasarella ka nevojë për ndërhyrje urgjente pasi tani në dimër është bërë shqetësim për shumë prej lagjeve që lidhen me qytetin.
11. Në kopshtin e Semanit edhe kudo tjetër bëni parqe lojrash që të lozin fëmijët, dhe mos të ngjiten nëpër kangjella.
12. Duhet të rikthehet parkimi në pedonalen kryesore të qytetit sepse janë penalizuar të gjithë bizneset.
13. Banesa sociale për familjet e pastreha. Për bujqësinë ujitja dhe kullimi. Dhe investime në rrugë. Këto 3 pika për mua janë mëse të nevojshme. Jo se nuk ka pika të tjera të nevojshme por këto janë më emergjentet.
14. Këto tre kategori mendoj se janë më të domosdoshme.
15. Lagjia "Afrimi Ri", rruga Cercem Celu, komplet kjo lagje nuk ka as edhe një lloj kanalizimi për ujrën e zeza, dhe aq me keq ujë çezme por janë të gjithë me puse. Dhe e kanë premtuar këtu e 12 vjet për ujin dhe askush nuk ka bërë asgjë. Faleminderit!
16. Dhe sa për sportin është turp që Apollonia është në këtë gjendje dhe Z.Subashi bëri premtim të madh për Apollonin dhe se ka çuar në super lig dhe duhen ujë kanalizime Flm forca Apollonia.
17. Jam banorë e lagjes "Kryengritja e Fierit". Mendoj se e kemi tepër urgjente ndërhyrjen në trotualet që i përkasin rrugës "Aulona" nga rrethrotullimi pranë ish QTU drejt Vlorës. Gjithashtu një shqetësim tepër primar mbetet prerja ose dhe mirëmbajtja e rrapenjëve që janë një kërcënim serioz për banorët e lagjes tonë.
18. Rrit të ardhurat e popullsisë të fshatit e më tej ul çmimet e prodhimeve bujqësore.
19. Duhet me patjetër Pallati i sportit i lojrave me dore për rinin Fierake. Është emergjente për mendimin tim dhe të shumë sportdashësve Fierak.
20. Lagja "11 Janari" ish kinemaja, investim në rrugën urbane.
21. Janë gjëra që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme dhe të vazhdueshme. Faleminderit!
22. Infrastruktura në hyrjen e shkollës "J. Kilica" është e dëmtuar, duhet rikonstruksion i rrugës dhe trotuarit. Gjimnazi nevojitet të ketë sistem ngrohjeje.
23. Lagjia Celigrad është në gjendje skandaloze, asnjë interes nga bashkia për shumë kohë ose të paktën një takim me banorët, bëhet fjalë për rrugën përball market Dea pasi rrugët nuk kanë emër ndrohen shpesh. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe kohën e marrë.
24. Shkollat e mesme duhet të kenë më tepër kontroll sepse siç e dinë të gjithë fierakët, si ta merr miku gjimnazin nuk ta merr vetja jote. Shumë nota janë pa merit, bursat janë pa merit, u jepen nxënësve që janë ose fëmijë mesuesish ose kanë një familjar tjetër mesues. Për sa i përket spitaleve, janë në gjendje të mjerueshme, ka mungesa mjekësh, shumë vonesa në analiza, analiza të thjeshta nuk realizohen fare, mjekët të paaftë.
25. Qyteti i Fierit është zgjeruar në 20 vitet e fundit, dhe ka marrë në administrim gjithë periferitë, Sheq i Madh, Afrim i Ri, Ferma Çlirimit, Zhupan, Portez, këto lagje të

Fierit nuk kanë kanalizime të ujrave të zeza, ujësjellës. Para 1 jave më duket se Kryetari Bashkise Fier, firmosi një Investim me të huajt për 13 Milion Euro për këto zona. Uji që merret me pompa nga pusët po sëmur njerëzit, ka përzierje me gropat septike.

26. Do ishte pak mirë që ndihma sociale t'i hidhte një sy pensioneve ose të papunëve dhe ndonjë kthim koke nga fshatrat.
27. Është urgjente që në rrugën Pogace në Mbrostar Ferko të bëhet të paktën një trotuar fund e krye në një gjatësi rreth 1 km sepse në atë rrugë kalojnë me qindra fëmijë, dy herë në ditë, për arsye se aty ndodhen tre shkolla. Do të na bëhet ndonjë gjëmë nëse nuk e bëjmë urgjent. Ta parandalojmë, vetëm një trotuar kërkohet.
28. Në Fier sinjalistika është shumë e dobët. Ka shumë pjesë ku trotuaret nuk ekzistojnë. Rruga më kryesore për qytetin është rruga e spitalit. Ku është zaptuar padrejttishtë nga disa të fort. Edhe nga qytetarët që shkelin tabelat. Ju lutem këtu duhet ndërhyr urgjentisht! Edhe rruga e lagjes "Një Maj" kodër. Nuk është vënë dorë që prej krijimit të saj. Mund të quhen qytetarët e asaj zone të paparë ndonjëherë nga Bashkia Fier. Shpresoj ta merrni për bazë ndonjë nga këto sugjerime. Ju faleminderit!
29. Mendoj që është shumë i rëndësishëm rindërtimi dhe rivënia në funksion në kushte optimale i pallatit të sportit në qytetin e Fierit. Kam ndjekur disa ndeshje të ekipeve të Apollonisë në Volejboll dhe Basketboll dhe kam udhëtuar drejt qyteteve të tjera sepse në Fier nuk kishin ambjente për realizimin e këtyre ndeshjeve. Kjo pastaj ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në nivelin e sportit në këtë qytet.
30. Të bëhet pallati i sportit.
31. Është bërë punë e mirë në Fier nga ana e bashkisë këto vitet e fundit. Mendoj se ka akoma për tu bërë dhe për të përmirësuar. Në fushën e sportit duhet të ketë më shumë investime, pasi sporti në qytetin tonë nuk është në lartësinë e duhur. Gjithashtu edhe investimet në rrugë dhe në shkolla janë të rëndësishme. Suksese në punën tuaj, vlerësojmë këdo që punon me ndershmëri dhe përkushtim për qytetin tonë.
32. Të rritet buxheti për personat që marini ndihmë ekonomike nga paaftësia si dhe të përfshihen në ndihma plus nga fondet që Bashkia ka në dispozicion. Moshë e tretë pensionistët të kenë më shumë investime për të përmisuar sado pak jetesën e tyre.
33. Komunitetit rom të Levanit i duhen këto përzgjedhje që shënova faleminderit për mirëkuptimin.
34. Rruga Fier-Seman me kors biçiklete anash, deri në det.
35. Për fshatin Kashisht NJ.A.Frakull e madhe të bëhet kanali i vaditjes që është prishur nga lumi që në 2015 dhe nuk mund të vadisim dot, besoj se mund të jetë një investim i nevojshëm për fshatin tonë.
36. Rrugët në fshat janë për faqe të zezë.
37. Këto mendoj se janë edhe të mundshme për tu realizuar.
38. Duhet sa më shume gjelbërim në rrugën Avdyl Frashëri Sheq i Madh.
39. Arsimi 9-vjeçar të kenë mundësi nxënësit me prindërit në punë të jenë me studim mos të detyrohen të shkojnë në privat për shkak të orarit të shkurtër.
40. Mendoj se duhet të ndërtohet një banesë sociale që të jetë një shtëpi për të gjithë të pastrehët. Shtimi i parqeve publike për fëmijë dhe thjesht hapsira të gjelbëruara me pemë e lule. Sinjalistika rrugore nuk ekziston dhe nuk zbatohet. Duhet vendosur.
41. Të ndërtohet pallati i sportit pasi nuk ka ambiente ku ekipet e lojtrave me.eore të stërviten dhe të zhvillojnë ndeshjet.
42. Investime në rrugën Vangjel Capo lagjia "Liri".
43. Pallat sporti.

44. Investim në rrugët e brendshme dhe atje ku ka filluar të eci treni me "zigzage". Sinjalistika rrugore "policët shtrirët e ata në këmbë, ka ardhë e ka kaluar koha për semafor. Ujitja dhe kullimi. Të hapen hartat e viteve 80-90 ku kanë qenë të mirë organizuara rrjeti vaditës e kullues. Udhëheqësit për punimet të jenë specialistë e jo socialistë e demokrat.
45. Ndërtimin e një ambjenti për lojrat me dorë pasi kemi vite që luajmë jashtë qytetit.
46. Për zërin 1. Sygjerohet ndriçimin e varrezave publike, zgjerim dhe sistemim të rrugëve ndarëse të parcelave. Për zërin 2. Cilësia e shenjave horizontale pra e bojës duhet të jetë parësore. Për zërin 3. Sygjerohet shtim të literaturës së bibliotekës. Dhe krijimin e sallave sa më komode. Ju Faleminderit!
47. Veç këtyre do të dija që bashkia të shtonte hapësirat e gjelbërta, më tepër fokus tek shtresat me vunerabël, dhe më tepër terrene sportive pasi investimi në sport është investimi më i sigurt. Do të doja që bashkia të hapte një mense që të mos ketë me uri në Fier. Gjithashtu do të doja që bashkia të shuante etjen e kalimtarëve në rrugë gjatë verës duke bërë disa çezma nëpër rrugë. Do të doja që ky buxhet të ishte buxheti i njerëzve në nevojë.
48. Për familjen e varfër.
49. Vendosni semaforë në rrugët e qytetit, në pikat kyçe të paktën.
50. Uljen e taksave.
51. Keni mbi 15 vite që thoni për të ndërtuar pallatin e sporteve në Fier. Nuk mendoni se ka ardhur koha për ta ndërtuar?
52. Përshëndetje dua të them një mendimin tim jo i imi por i disa personave për rrugën në fshatin Tin Kreshpan ku rrugët për të vajtur fermerët të tokat janë copa nuk mund të kaloshë në këmbë jo më mjete. Pse nuk i hidhni një sy të paktën një rrugullim të lehtë, por gjithsesi për Fierin keni bërë shumë, bravo. Por shikoni dhe fshatrat në fillim.
53. Për katër vite investimet e bashkisë kanë arritur nga ish-QTU deri tek shkolla e Muzikës. Për këto 4 vite mbase shkon deri në Qenas apo Sheq, për mbase 8 vitesh, mbase mbërrin në Qafë të Koshovicës, Fermë, Mbrosta-Ura apo Portez. Nuk e di nëse pas 12 vitesh nga sot, do të arrihet të investohet në 4 ekstremet e territorit të bashkisë Fier, duke mbuluar të gjitha fshatrat e saj.
54. Duhet investuar dhe në reparte e zjarrfikses, janë në mjerime total mzsh e Fierit.
55. Shpresojmë sa më të mirën.
56. Shtoj gjithashtu dhe Hapësirat Publike (trotauret e zëna nga karriket dhe tavolinat e lokaleve).
57. Zonat periferike të Fierit nuk kanë marrë investimet e merituar.
58. Ktheni PRONAT tek pronarët. Jepni tapitë e shtëpive dhe pronave.
59. Ulja e numrit të fëmijëve në kopshte. Me kopshtet jeni (ushqim, ngrohje, dushe diellor). Hapja e çerdheve në çdo lagje (shumë emergjente). Uroj të merren parasysh. Respekte!
60. Ndërtimi i pallatit të sportit për lojrat me dorë.
61. Nuk ka asnjë investim me plan afatgjatë. Të gjitha bëhen sa për tendera. Asnjë investim për gjelbërim, rrugë të saposhtruara me cilësi skandal dhe bibliotekë që nuk funksionon.
62. Mendoj se duhet të vini një linjë urbane me një autobus linja Shtyllas-Jaru-Levan-Fier.
63. Nuk është qyteti vetëm nga njëri krah i lumit Gjanica, supozohet që lumi i kalon përmes qytetit. Sikur të vinit dorë e në atë krah që nuk keni bërë asgjë deri tani, mirë do ishte.
64. Përshëndetje! Rrugët dhe kanalizimet në Celingrad pothuajse nuk ekzistojnë fare.



65. Shikoni fshatrat e Njësisë Administrative Libofshë.
66. Merruni dhe me fëmijët 0-3 vjeç që kanë nevojë për trajtim mjekësor ose operacion të kushtueshëm siç është Implanti Koklear.
67. Lagjia “Sheq i Madh” e ka infrasktuturën shumë të keqe për shembull Rruga “Riza Hoxha”.
68. Të bëhet akoma më shumë rreth kulturës.
69. Punofshi dhe nëpër fshatra si Seman se është harruar që ekziston nga ana e bashkisë.
70. Përshendetje! Nga fshati Ade1, Njësia Administrative Frakull, Fier, sa për investimet nga bashkia për ne janë zero. Kemi 20 vite pa ujë dhe duke e ditur mirë që uji na kalon te dera e shtëpisë. Rrugët pa asnjë lloj investimi. Para ca ditësh erdhën trimat e bashkisë e na hodhën nja dy kamiona me baltë. Ndriçimi le për të dëshiruar, 4 drita një fshat i terë, turp i Zotit. Pa kanalizime etj. Gjithashtu dhe për parcelat nuk hyjmë dot në tokat tona, vetëm me traktora dhe na kërkojnë taksat.
71. Një qytet si Fieri e meriton një ekip futbollit si çdo qytet normal, kjo duhet bërë pa tjetër kemi 20 vjet që presim, nuk ka më justifikime nqs nuk e beni jeni zero. Fierit nuk i mungojnë sponsorët as tifozët thjesht nuk keni editor ta menaxhoni. Duhet një zgjidhje e shpejt.



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**